



VENDIM
Nr.61 Datë 13.09.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
OSSH SH.A PËR MIRATIMIN E PLANT TË INVESTIMEVE TË VITIT
2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i OSSH sh.a për planin e investimeve për vitin 2011 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a për miratimin e plant të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH Sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Bujar NEPRAVISHTA

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al